



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SEKTORI I PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, me . . . 2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sigurimi i Shëndetit dhe Përgjegjësisë Profesionale të Specializanteve”, e ndarë në 2 (dy) Lote:

- Loti I: “Blerje siguracioni për sigurimin e shëndetit të studentit specializant të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”
- Loti II: “Blerje siguracioni për sigurimin e përgjegjësisë profesionale të studentit specializant të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- shërbime për siguracion -6510000-8, Shërbim për siguracion të detyrueshëm profesional 66516500-5, Shërbime për siguracion nga sëmundjet dhe aksidentet 66720000-3.

VLERA E FONDIT LIMIT:

Objekti: “Blerje siguracioni për shëndetin dhe përgjegjësisë profesionale të studentit specializant në UMT”, me Fond Limit total: 13,731,653.32 (trembëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre pike tridhjetë e dy) lekë pa TVSh, e ndarë në 2 lote, si më poshtë vijon:

LOTI I - ”Blerje siguracioni për sigurimin e shëndetit të studentit specializant” me fond limit total 5,740,737.52 (pesë milion e shtatëqind e dyzetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë pikë pesëdhjetë e dy) lekë pa tvsh.

LOTI II – “Blerje siguracioni për sigurimin e përgjegjesisë profesionale të studentit specializant” 7,990,915.80 (shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë pikë tetëdhjetë) lekë pa tsvh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, **Universiteti i Mjekësisë, Tiranë si Organi Qendror Blerës**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi janë standarde dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (TË NJËJTA PËR TË GJITHA LOTET)

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje të nenit 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76, 82 dhe 83 të L.PP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Ofertuesi duhet të jetë kompani sigurimesh, e cila të përmbushë të gjitha kërkesat e Legjislacionit të fushës, e pajisur me leje për ushtrim të aktivitetit sigurime dhe/ose risigurime nga Autoriteti i

Mbikqyrjes Financiare, ku të jenë specifikuar qartë grupet/klasat për sigurimet e kërkuara në këtë tender dhe në specifikimet teknike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a, 1/c dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2 Kopje të çertifikuara të pasqyrave financiare të tre viteve të fundit (2020, 2021, 2022), që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatimit Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizës dhe Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c", të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e L.P.P, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Akt Ekspertizës dhe Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", indryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel".

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 %, të vlerës së përlogarit të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët Ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 %, të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben Autoriteti Kontraktor, për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në këtë fushë. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe/ose atë publik.

* * *

Pasi lexohet, procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Ky procesverbal mbahet në 2 (dy kopje), 1 (një) kopje për dosjen e prokurimit dhe 1 (një) kopje për Zyrën e Protokollit.

NJESIA E PROKURIMIT:

Pirro Kushi

Lamiela Masho

Eldorado Sulaj